

SYLLABUSI I LËNDËS:
HYRJE NË METODAT HULUMTUESE

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	Hyrje në metodat hulumtuese
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti 2, Semestri 3
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	<i>Caktohet nga dekanati në fillim të semestrit</i>
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.dr. Avdullah Hoti
Detajet kontaktuese:	Fakulteti Ekonomik, UP, Kati VI, kabineti 75 Email: avdullah.hoti@uni-pr.edu Konsultimet: <i>caktohen në fillim të semestrit</i>
Përshkrimi i lëndës:	Kjo lëndë do të ofrojë një mundësi për studentët që të krijojnë dhe të avancojnë kuptimin e tyre të kërkimit përmes hulumtimit empirik, si dhe të kuptuarit e etikës dhe qasjes adekuate në hulumtime. Temat e kursit përfshijnë: (1) Qasjet themelore të hulumtimit dhe filozofitë, (2) Përdorimi i teorisë, hipotezave, pyetjeve kërkimore dhe variablave në hulumtim, (3) Hartimi i hulumtimeve, qasjet e mostrimit dhe çështjet etike, (4) Termat bazë dhe kriteret e cilësisë në hulumtimin sasior dhe cilësor, (5) Përdorimi i metodave sasiore në hulumtime, duke përfshirë analizën e treguesve statistikorë dhe ekonometrik si: korrelacioni, regresioni, analiza e modës, mesatareve, zbatimi i t-testit, modeli i ekuacioneve për punë empirike etj. (6) Metodot cilësore si: qasjet e intervistave, metoda e studimit të rastit, analiza narrative, hulumtimi kritik etj.
Objektivat e lëndës:	Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që t'i njoftojë studentët me shumicën e metodave sasiore si dhe cilësore të përdorura më së shpeshti nga studiuesit e ekonomisë. Njohja bazë e këtyre qasjeve metodologjike është absolutisht e rëndësishme për të kuptuar publikimet akademike, vlerësimin e studimeve empirike dhe hartimin e projekteve të tyre kërkimore. Studentët gjithashtu do të jetë në gjendje të zhvillojë qasjen e tyre për të kuptuar më mirë literaturën përmes të kuptuarit të metodologjisë kërkimore. Përveç kësaj, studentët do të mësojnë të përgatisin projektin e tyre

	kërkimor.		
Rezultatet e të mësuarit:	Pas përfundimit të suksesshëm të këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje të: • Të definojë hulumtimin, të shpjegojë dhe të zbatojë termat e hulumtimit; • Të përshkruajë procesin e hulumtimit dhe aktivitetet parimore, aftësitë dhe etikën e lidhur me procesin e kërkimit; • Të shpjegojë marrëdhënien midis teorisë dhe hulumtimit; • Të përshkruajë dhe krahasojë metodat kryesore hulumtuese sasiore dhe cilësore; • Të propozojë një studim kërkimor dhe të justifikojë teorinë, si dhe vendimet metodologjike, duke përfshirë marrjen e mostrave dhe matjen; • Të kuptojnë rëndësinë e etikës kërkimore dhe të integrojnë etikën kërkimore në procesin e hulumtimit; • Të jetë në gjendje të vlerësojë dhe të kritikojë një artikull të botuar që përdor një nga metodat primare të hulumtimit në terren; • Të jetë në gjendje të ndërtojë një pyetësor efektiv që përmban disa lloje të pyetjeve të anketës.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (orët për semestër, ECTS)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	13	2	26
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet			
Ushtrime në terren			
Kollokfiume,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	10	1	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	15	2	30
Përgatitja përfundimtare për provim			
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)			
Projektet,prezantimet etj	15	2	30
Totali			100
Metodologjia e	Shpjegimet teorike dhe shembujt praktikë		

mësimdhënies:	përdoren gjatë gjithë kursit, duke synuar të ofrojnë njohuri për të përmirësuar metodat e hulumtimit dhe shkathtësitë e shkrimit për hulumtim/akademik. Metoda e mësimdhënies është interaktive dhe u mundëson studentëve që të bëjnë pyetje gjatë gjithë kohës.
Metodat e vlerësimit:	Për të marrë vlerësim pozitiv në këtë kurs, studenti duhet të demonstrojë se: (i) është i familjarizuar me specifikat e metodologjisë standarde hulumtuese, (ii) mund të aplikojë këtë metodologji në hulumtime dhe (iii) mund të aplikojë rregullat e shkrimit akademik në hulumtime shkencore. Provimi në kudër të këtij kursi është individual dhe konsiston në një punim që studentët e punojnë në klasë, duke u koncentruar në këto çështje: (i) Arsyeshmëria e hulumtimit: qëllimi dhe propozimet e mundshme që mund të rezultojnë nga ky hulumtim. (ii) Metodologjia hulumtuese: qasja metodologjike në hulumtim, metoda më adekuate dhe arsyeshmëria e përzgjedhjes së metodës së caktuar dhe (iii) Të dhënat: analiza e mostrës, madhësia e saj dhe treguesit statistikor të dhënat e grumbulluara.
Literatura	
Literatura bazë:	1. Saunders, M., Lewis, P., & Thornhill, P. (2009). Research methods for business students (5th edition). Harlow: Pearson. 2. Bob Matthews & Liz Ross (2011) Research Methods: A Practical Guide for the Social Sciences 3. Bryman, A. and D. Crammer. 2004. Quantitative Data Analysis with SPSS 12 and 13: A Guide for Social Scientists. London: Routledge. 4. Pelosi, M.K. and T.M. Sandifer. 2002. Doing Statistics for Business with Excel: Data, Inference and Decision Making (Second Edition). New York: John Wiley and Sons. 5. Creswell, J. W. .Research design: Qualitative, quantitative and mixed methods approaches. 3rd Ed.. Thousand Oaks, CA: Sage., 2009.
Literatura shtesë:	1. Quantitative Methods for Business, Management and Finance, Swift, L. and Piff, S.,

	Palgrave Macmillan, New York
Plani i detajuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje në hulumtime shkencore
Java e dytë:	Metodologjia e hulumtimit dhe fazat e procesit hulumtues
Java e tretë:	Rishikimi i literaturës dhe të lexuarit kritik
Java e katërt:	Hartimi i hulumtimit dhe marrja e mostrave
Java e pestë:	Mbledhja e të dhënave primare
Java e gjashtë:	Mbledhja e të dhënave sekondare
Java e shtatë:	Pyetësorët dhe intervistat
Java e tetë:	Testi i parë
Java e nëntë:	Analiza cilësore e të dhënave
Java e dhjetë:	Analiza përshkruese sasiore
Java e njëmbëdhjetë:	Korrelacioni dhe regresioni
Java e dymbëdhjetë:	Analiza statistikore e avancuar
Java e trembëdhjetë:	Testet e matjes dhe cilësisë
Java e katërbëdhjetë:	Kryerja e kërkimit dhe nxjerrja/prezantimi i rezultateve
Java e pesëmbëdhjetë:	Testi i dytë
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme. Studentët inkurajohen që të kërkojnë sqarime gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve. Mësimdhënësi do të jetë në dispozicion për sqarime shtesë dhe konsultime të studentëve. Studentët kanë për obligim që pas çdo ligjërata të lexojnë së paku literaturën që ju është caktuar dhe të kryejnë detyrat dhe esetë që do t'u jepen. Studentët nuk janë të obliguar tu nënshtrohen vlerësimeve gjatë semestrit. Studentet inkurajohen të përcjellin diskutimet publike dhe të hapin diskutime gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve lidhur me to. Studenti duhet të jetë të respektojë institucionin dhe rregullat akademike, orarin e ligjëratave dhe ushtrimeve, si dhe të jetë i angazhuar gjatë zhvillimit të orës mësimore. Është e obligueshme posedimi i ID-së në teste dhe provim. Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet tu përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi lidhur me rregullat akademike për realizimin e hulumtimit.	